

V E N D I M
Nr. 477, datë 31.8.2000

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.51, DATË 17.2.2000, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE, “PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR.248, DATË 25.3.1996, TË
KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR PËRCAKTIMI E NUMRIT DHE KATEGORISË SË
TELEFONAVE CELULARË, NË PËRDORIM TË INSTITUCIONEVE BUXHETORE””**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të ligjit nr.8379, datë 29.7.1998, “Për hartimin dhe zbatimin e buxhetit të shtetit në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Në pikën 3, të vendimit nr.51, datë 17.2.2000, të Këshillit të Ministrave shtohet një paragraf, me këtë përmbajtje:

“I hiqet kufiri i shpenzimeve të përballueshme nga buxheti i shtetit, për përdorimin e telefonit celular edhe zëvendësministrit të Rendit Publik, drejtorit të Kabinetit të Kryeministrit, drejtorit të Departamentit të Informacionit, në Këshillin e Ministrave, drejtorit të Përgjithshëm të Policisë dhe drejtorit të Policisë Kriminale”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta